

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Njësia e Auditimit të Brendshëm / Jedinica Unutrašnje Revizije / Internal Audit Unit

# STATUTI

## I

### NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË KOMUNËN E GJILANIT

Gjiçan, Tetor 2019

Në bazë të nenit 25 pika 3.1 dhe 3.2. të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, standardeve të atributit nr. 1000, 1000.A1, 1000.C1, dhe 1010 të Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe pikës 3.1.2 të Doracakut të Auditimit të Brendshëm, drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, nxjerr dhe dorëzon për miratim të Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit këtë:

# **STATUT**

## **TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË KOMUNËN E GJILANIT**

### **KAPITULLI I**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Në bazë të nenit 23 pika 1 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëheqësi i Subjektit të Sektorit Publik (USSP), është përgjegjës për funksionimin efektiv të Auditimit të Brendshëm në pajtim me kërkesat e këtij ligji.

##### **Neni 2**

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), është pjesë e Administratës së Komunës së Gjilanit.

##### **Neni 3**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në strukturën organizative vendoset si njësi e pavarur nga të gjitha funksionet tjera.

##### **Neni 4**

Selia e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është në ndërtesën e Komunës së Gjilanit – në kuadër të zyrave të kryetarit.

### **KAPITULLI II**

#### **KOMPETENCAT E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

##### **Neni 5**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, i ushtron kompetencat e veta në përputhje me Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

##### **Neni 6**

Çdo ndryshim i Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, lidhur me kompetencat e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, duhet të zbatohen menjëherë pas hyrjes në fuqi gjatë punës së njesisë.

#### **Neni 7**

Rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, kodi i etikës dhe standardet profesionale për ushtrimin e auditimit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, përgatiten nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm dhe miratohen nga Ministri i Financave.

### **KAPITULLI III**

#### **MISIONI DHE FUSHËVEPRIMI**

##### **Neni 8**

Misioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është të ofroj shërbime të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë operacionet e organizatës. Ai e ndihmon organizatën që të arrij objektivat e saja duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

##### **Neni 9**

Fushëveprimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është që të përcaktojë nëse rrjeti i organizatës për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes siç është dizajnuar dhe përfaqësuar nga menaxhmenti, është adekuat dhe funksionon në atë mënyrë të siguroj që:

- a). rreziqet të identifikohen dhe menaxhohen si duhet;
- b). ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes të ndodhë sipas nevojës;
- c). informata të mjaftueshme financiare, menaxheriale dhe operative të jenë të sakta, të besueshme dhe me kohë;
- d). veprimet e punonjësve të jenë në pajtueshmëri me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e aplikueshme;
- e). burimet të sigurohen në mënyrë ekonomike, të përdoren me efikasitet dhe të mbrohen në mënyrë adekuate;
- f). të arrihen programet, planet dhe objektivat;
- g). cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm, të promovohet në procesin e kontrollit të organizatës dhe
- h). çështjet e rëndësishme legjislative ose rregulloret që kanë ndikim në organizatë të jenë pranuar dhe adresuar si duhet.

##### **Neni 10**

Mundësitë për përmirësimin e kontrollit të menaxhmentit dhe imazhit të organizatës që mund të identifikohen gjatë auditimeve. Ato do të komunikohen te nivelet adekuate të menaxhmentit (Kryetarit të Komunës) dhe Komitetit të Auditimit.

##### **Neni 11**

NJAB-ja, gjatë auditimit bënë grumbullimin e informacioneve duke përdorur burime të ndryshme si nga dosjet e përhershme për organizatën, burimet e identifikuara në takimin fillestar nga menaxhmenti i organizatës që auditohet dhe burime të tjera.

#### **Neni 12**

Fushëveprimi ose periudha që auditohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për njësinë e auditimit, do të përcaktohet paraprakisht bazuar në planin vjetor dhe strategjik dhe do të auditohet në varësi prej shkallës së rrezikut të cekura në Planin Strategjik të NJAB-së, duke përfshirë edhe periudhën deri në momentin e fillimit të auditimit për vitin kalendarik që auditohet dhe ndahet sipas koeficienteve të rrezikshmërisë gjithnjë sipas gjasës dhe ndikimit, nëse ndodhë ai rrezik.

### **KAPITULLI IV**

#### **LLOGARIDHËNIA**

#### **Neni 13**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në përmbushjen e detyrave të tij/saj do të jetë llogaridhënës ndaj Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), në nivel qendror që të:

- a). ofrojë për çdo vit vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e proceseve të organizatës për kontrollimin e aktiviteteve të saja dhe menaxhimin e rrezeve të saja në fushat e vëna nën misionin dhe fushëveprimin e punës;
- b). raportojë çështjen e rëndësishme që ndërlidhen me proceset për kontrollimin e aktiviteteve të organizatës dhe partnerëve të saj, përfshirë edhe përmirësimet potenciale të atyre proceseve dhe ofrimin e informatave për sa i përket çështjeve të tilla nëpërmjet zgjidhjeve;
- c). Ofrojë periodikisht informatat mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të NJAB-së; dhe
- ç). koordinoj dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimi i rrezikut, pajtueshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

### **KAPITULLI V**

#### **PAVARËSIA FUNKSIONALE**

#### **Neni 14**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm Kryetarit të Komunës dhe e njofton Komitetin e Auditimit.

#### **Neni 15**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë punës duhet t'i përmbahet parimeve për funksionimin e auditimit të brendshëm sipas nenit 18 të Ligjit nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

#### **Neni 16**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, nuk ndikohet nga personat me autoritet nga brenda ose jashtë subjektit të sektorit publik.

## **KAPITULLI VI**

### **TË DREJTAT E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE AUDITORËVE TË BRENDSHËM**

#### **Neni 17**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm kanë të drejtë:

- a). në qasje të lirë te menaxhmenti, anëtarët e personelit dhe pasuritë e subjektit të sektorit publik, që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimit;
- b). në qasje të lirë në të gjitha informatat, përfshirë ato të klasifikuara sipas nivelit të tyre të qasjes së lejuar, qasje në sistemet e teknologjisë informative, të gjitha dokumentet dhe të dhënat në dispozicion, përfshirë edhe ato elektronike, që janë të domosdoshme për kryerjen e auditimit;
- c). të kërkojnë nga zyrtarët përgjegjës çfarëdo të dhëna, pasqyra përmbledhëse, opinione, konfirmime, dokumentet dhe informata tjera të nevojshme, në lidhje me detyrën e auditimit;
- ç). të kenë qasje në Komitetin e Auditimit;
- d). të alokojë burimet, përzgjedhë temat, përcaktoj fushëveprimin e punës t'i zgjeroj ato dhe aplikoi teknikat e kërkuara për të arritur objektivat e auditimit; dhe
- e). të marr asistencën e nevojshme të personelit në njësitë e organizatës, ku ata kryejnë auditimet, si dhe shërbimet tjera të specializuara nga brenda organizatës ose jashtë saj.

## **KAPITULLI VII**

### **OBLIGIMET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE AUDITORËVE TË BRENDSHËM**

#### **Neni 18**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgjegjës për:

- a). aktivitetet e përgjithshme të Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
- b). të vepruar në pajtueshmëri me standardet e auditimit të brendshëm dhe rregulloret e auditimit brendshëm si dhe metodologjinë e miratuar nga Ministri i Financave;
- c). përgatitjen dhe dorëzimin e planit strategjik dhe planit vjetor duke përdorur metodologjinë adekuate që bazohet në rrezik, përfshirë çfarëdo shqetësimi për rrezik ose kontroll të identifikuar nga menaxhmenti për rishikim dhe miratim te kryetari i Komunës dhe te Komiteti i Auditimit;
- d). bashkërendimin e ndërveprimit me Njësine Qendrore Harmonizuese dhe me institucionet e auditimit të jashtëm, para dorëzimit të regjistrave apo raporteve palëve të jashtme, drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm merr aprovimin nga kryetari i Komunës;
- e). dërgimin e raporteve gjashtë (6) mujore dhe vjetore te Njësia Qendrore Harmonizuese më së largu deri më 15 korrik të vitit, respektivisht deri më 15 janar të vitit pasues;
- f). zbatimin e planit vjetor të auditimit siç është miratuar përfshirë edhe ndonjë detyrë (auditim) që kërkohet nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit;
- g). mbajtjen e personelit profesional të auditimit me njohuri të mjaftueshme shkathtësi, përvojë, dhe certifikim profesional për të përmbushur kërkesat e këtij statuti;
- h). themelimin e programit të sigurisë të cilësisë me anë të së cilit drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm siguron funksionimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm;

- i). kryerjen e shërbimeve këshillëdhënëse, përtej shërbimeve të auditimit të brendshëm për siguri, të asistojë menaxhmentit në arritjen e objektivave. Shembujt mund të përfshijnë lehtësimin, dizajnimin e procesit, trajnimin dhe shërbimet këshillëdhënëse;
- j). zhvillojë dhe vlerësoj funksionet e rëndësishme të shkruara/konsoliduar dhe shërbimet, proceset, operacionet dhe proceset e kontrollit që janë të reja ose në ndryshim e sipër që përkojnë me zhvillimet e tyre, zbatimin dhe /ose shtrirjen;
- k). asistojë në hetimin e aktiviteteve të rëndësishme të dyshuara për mashtrim brenda organizatës dhe të njoftojë Kryetarin e Komunës dhe Komitetin e Auditimit për rezultatet; dhe
- l). mirëmbajtja dhe ruajtja e të gjitha dosjeve të raporteve të auditimit, shënimeve gjithë përfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmi që kanë të bëjnë me ato raporte dhe të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmentit të organizatës buxhetore, njësisë buxhetore apo njësisë shpenzuese, menaxhmentit të lartë dhe komitetit të auditimit së paku për shtatë (7) vite.

#### **Neni 19**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm:

- a). ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive, profesionale dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe metodologjisë së auditimit të brendshëm për sektorin publik, të miratuar nga Ministri i Financave;
- b). veprojnë në përputhje me kriteret e përcaktuara në kodin e etikës, planin e auditimit dhe rregullat për konfidencialitet për auditimin e brendshëm dhe
- c). zhvillojnë vazhdimisht njohuritë dhe shkathtësitë profesionale, dhe ruajnë certifikimin e tyre profesional duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 22 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

#### **Neni 20**

Në rast të dyshimit për mashtrim gjatë auditimit, auditori i brendshëm njofton Drejtorin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, i cili menjëherë njofton Kryetarin e Komunës ose autoritetet kompetente.

#### **Neni 21**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, cakton ekipin e auditimit dhe udhëheqësin e ekipit të auditimit.

#### **Neni 22**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, duhet ta rishikoj dhe ta nënshkruaj raportin përfundimtar final dhe ta dërgoj atë te Kryetari i Komunës dhe te menaxhmenti i subjektit të audituar.

#### **Neni 23**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm nuk janë të autorizuar që të:

- a). kryejnë ndonjë detyrë operative për organizatën ose partnerët e saj;
- b). iniciojë ose miratoi transaksionet e kontabilitetit që janë jashtë departamentit të auditimit të brendshëm; dhe
- c). drejtojë aktivitetet e punonjësve të organizatës që nuk janë punësuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, përveç deri në atë shkallë kur punonjësit e tillë janë caktuar në ekipin e auditimit si duhet, ose ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar auditorët e brendshëm.

## KAPITULLI VIII

### PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT TË LARTË TË KOMUNËS PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

#### Neni 24

Kryetari i Komunës:

- a). siguron burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe tjera për të mundësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë efektive;
- b). miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm të cilat dorëzohen në Njësinë Qendrore Harmonizuese, më së largu deri më 31 dhjetor të vitit fiskal;
- c).siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm;
- d). dorëzon Njësisë Qendrore Harmonizuese raportin vjetor për aktivitetet e auditimit të brendshëm, sipas nenit 16 të të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe
- e). të eliminojë parregullsitë e zbuluara gjatë auditimit si dhe zbatimin e masave për të parandaluar parregullsitë e tilla në të ardhmen.

## KAPITULLI IX

### SHËRBIMET E SIGURISË

#### Neni 25

Shërbimet e sigurisë përfshijnë vlerësimin objektiv të dëshmive për të dhënë një mendim apo konkluzion të pavarur në lidhje me një proces, sistem apo ndonjë çështje tjetër në fjalë.

#### Neni 26

Natyra dhe fushëveprimi i angazhimit të sigurisë përcaktohen nga auditori i brendshëm.

#### Neni 27

Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, duhet të menaxhojë në mënyrë efektive aktivitetin e auditimit të brendshëm, për të siguruar se ai ia shton vlerën organizatës.

## KAPITULLI X

### SHËRBIMET E KONSULENCËS

#### Neni 28

Shërbimet e konsulencës, për nga natyra janë këshilluese dhe në përgjithësi kryhen me kërkesën e veçantë të ndonjë klienti të angazhimit.

#### Neni 29

Natyra dhe fushëveprimi i angazhimit të konsulencës, përcaktohen me një marrëveshje me klientin e angazhimit.

### **Neni 30**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, duhet të marrë në konsideratë që të pranojë angazhimet konsulente të propozuara, duke u bazuar mbi mundësitë e këtij angazhimi për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut, shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimeve të organizatës.

## **KAPITULLI XI**

### **KOMUNIKIMET DHE FORMAT E RAPORTIMIT**

#### **Neni 31**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm duhet t'i komunikoj rezultatet e angazhimit për secilin auditim.

#### **Neni 32**

Komunikimi duhet të jetë i saktë, objektiv, i qarta, konciz, konstruktiv, i kompletuar dhe me kohë.

#### **Neni 33**

Komunikimet duhet të përfshijnë objektivat dhe fushëveprimin e angazhimit, konkluzionet, rekomandimet dhe planet e veprimit që janë të zbatueshme.

#### **Neni 34**

Qëllimi kryesor i raportit të auditimit është të informohet zyrtari kryesor administrativ dhe menaxhmenti për rezultatet e auditimit, për të:

- a). dhënë një vlerësim të gjendjes së procesit të audituar, duke shprehur mendim të pavarur dhe objektiv për efektivitetin e procedurave të kontrollit që ka të bëjë me ligjshmërinë, menaxhimin e mirë financiar dhe transparencën; dhe për të
- b). dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit për të korrigjuar çdo gabim, dobësi dhe parregullsi të identifikuar nga auditimi.

#### **Neni 35**

Raportet e përpiluara si rezultat i angazhimeve konsultuese, apo hetimet e posaçme audituese për mashtrime të dyshuara, parregullsi apo korrupsion, do të jenë shumë konfidenciale dhe më formale se sa raportet tjera, që kërkojnë kujdes të veçantë dhe ndjeshmëri në përfundimin dhe zgjidhjen e tyre.

## KAPITULLI XII

### STANDARDET E PRAKTIKËS SË AUDITIMIT

#### Neni 36

Aktivitetet e auditimit të brendshëm të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, të vendosura nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në pajtim me parimet e sjelljes të Kodit të Etikës.

#### Neni 37

Qëllimi i standardeve është që të:

- a). bëjnë identifikimin e parimeve bazë, të cilat janë udhëzues të praktikës së auditimit të brendshëm;
- b). ofrojnë kornizën për kryerjen e një vargu të gjatë të aktiviteteve të auditimit të brendshëm që e shtojnë vlerën;
- c). vendosin bazat për vlerësimin e performancës së auditimit të brendshëm; dhe
- d). ndihmojnë përmirësimin e veprimeve dhe proceseve të organizatës.

#### Neni 38

Njësia e Auditimit të Brendshëm, do të përmbushë ose tejkalojë Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Auditorëve të Brendshëm.

## KAPITULLI XIII

### REKRUTIMI, KUALIFIKIMI DHE TRAJNIMI I AUDITORËVE TË BRENDSHËM

#### Neni 39

Rekrutimin e personelit për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, organizata buxhetore e bënë sipas legjislacionit për zyrtarët publik dhe kushteve të parapara në neni 22 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

#### Neni 40

Në komisionin e rekrutimit të drejtorit për Njësinë e Auditimit të Brendshëm, duhet të marrë pjesë një përfaqësues nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.

#### Neni 41

Kualifikimi, trajnimi dhe licencimi i personelit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm bëhet sipas nenit 30 paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 dhe 3.4. të Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

## **KAPITULLI XIV**

### **KUFIZIMET NË PUNËN E AUDITORËVE TË BRENDSHËM**

#### **Neni 42**

Auditorët e brendshëm në punën e tyre janë të pa anshëm, objektiv dhe raportojnë për çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit. Në lidhje me këtë auditorët e brendshëm:

- a). nuk përfshihen në realizimin e funksioneve të drejtpërdrejta të subjektit të sektorit publik;
- b). nuk mbajnë poste politike, nuk janë anëtarë aktivë të ndonjë subjekti politik dhe nuk emërohen në pozita drejtuese në strukturat e subjekteve politike; dhe
- c). nuk kryejnë angazhime auditimi për dhënien e sigurisë lidhur me funksionet, veprimtaritë dhe strukturat për të cilat ata kanë dhënë shërbime këshilluese ose në të cilat kanë qenë të punësuar gjatë periudhës së kaluar dy (2) vjeçare.

## **KAPITULLI XV**

### **KONFLIKTI I INTERESIT**

#### **Neni 43**

Në rastet kur ka konflikt të interesit apo dyshohet për mundësinë e ndodhjes së konfliktit të interesit, i paraparë si i tillë me legjislacionin në fuqi dhe i cili mund të paraqitet si rezultat i auditimit, atëherë auditori i brendshëm, detyrohet që ta njoftojë me shkrim drejtorin e njësisë apo personin kompetent në institucion. Pas njoftimit për një konflikt të tillë, apo mundësinë e ndodhjes, drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm apo personi kompetent, me qëllim të shmangies së një vepre të tillë cakton auditorin e brendshëm në detyra tjera.

#### **Neni 44**

Konflikti i interesit, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin e përgjithshëm, ekziston nëse:

- a). auditori i brendshëm ka punuar gjatë dy (2) viteve të fundit për subjektin që do të auditohet dhe për të cilin ka përcaktuar, vendosur dhe hartuar procedurat për sistemet ose proceset që janë subjekt i auditimit brenda vitit të kaluar;
- b). në mesin e menaxhementit dhe zyrtarëve të lartë që përfshinë auditimi, është personi me të cilin auditori i brendshëm ka pasur marrëdhënie afariste në dy (2) vitet e fundit dhe/apo ka marrëdhënie familjare deri në brezin e dytë të familjes, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi; dhe
- c). ka rrethana të tjera që mund të çojnë në konflikt të mundshëm interesi, nëse ato janë të konsideruara si të tilla dhe nëse ato janë shpjeguar me shkrim nga drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

## **KAPITULLI XVI**

### **MARRËDHËNIET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM ME AUDITORIN E JASHTËM**

#### **Neni 45**

Zyra Kombëtare e Auditimit, kryen audite të jashtme në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloret dhe aktet nënligjore të Kosovës.

#### **Neni 46**

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve me auditorin e jashtëm (në shumicën e rasteve, auditori i jashtëm është Zyra Kombëtare e Auditimit).

#### **Neni 47**

Qëndrimi i kooperimit dhe bashkëpunimit, përshkruan marrëdhënien ideale të Njesisë së Auditimit të Brendshëm me auditorët e jashtëm. Kjo marrëdhënie, e jo ajo e cila auditimin e brendshëm e konsideron si një vazhdim të rolit të auditimit të jashtëm, është e nevojshme për shkak të dallimit në objektiva. Auditorët e jashtëm, kryesisht janë të interesuar në ekzaminimin vjetor që merr formën e verifikimit të aseteve dhe detyrimeve në datën e caktuar dhe analizat e tilla të pasqyrave të të hyrave do t'ju mundësojnë atyre që të shprehin mendimin për saktësinë e pasqyrave financiare.

### **KAPITULLI XVII**

#### **MARRËDHËNIET E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM ME KOMITETIN E AUDITIMIT**

#### **Neni 48**

Komiteti i Auditimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm mbështeten në mënyrë reciproke. Njësia e Auditimit të Brendshëm mbështetë komitetin në çështjet në vijim:

- a). rishikimi i linjave raportuese funksionale dhe administrative të njësisë së auditimit të brendshëm në kuadër të organizatës, për të siguruar se mirëmbahet pavarësia e tyre;
- b). vlerësimi i përshtatshmërisë së personelit, përshtatshmërisë financiare dhe të burimeve të tjera në dispozicion për njësinë e auditimit të brendshëm;
- c). të siguruarit se nuk bëhet asnjë kufizim i burimeve apo fushëveprimit që do t'i pengonte aktivitetet e auditimit;
- d). sigurimi i raporteve të cilat përmbledhin aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe drejtimi i vëmendjes së komitetit në dobësitë e mëdha të sistemeve, rreziqeve dhe parregullsive operacionale;
- e). përcjellja e performansës së njësisë së auditimit të brendshëm në krahasim me planin vjetor të auditimit;
- f). raportimi me kohë i aktiviteteve joligjore, mashtruese apo korruptuese dhe
- g). sigurimi i vlerësimit të kualitetit të auditimit të brendshëm.

#### **Neni 49**

Komiteti i Auditimit mbështetë Njësinë e Auditimit të Brendshëm, duke plotësuar përgjegjësitë në vijim:

- a). siguron marrëdhënie efektive dhe bashkëpunuese ndërmjet; Udhëheqësit të Subjektit të Sektorit Publik, Zyrtarit Kryesor Financiar, Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe auditorit të jashtëm.
- b). miraton statutin e auditimit të brendshëm;
- c). Shqyrton dhe miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, pa pasur kompetenca drejtuese për këto dokumente;

- d). mbikëqyr dhe vlerëson performancën e aktivitetit të auditimit në përmbushjen e planit të miratuar përmes raporteve periodike nga udhëheqësi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
- e). siguron që mashtrimet e mundshme ose korrupsioni i dyshuar, të identifikuar nga raportet e auditimit të brendshëm ose të sjellë ndryshe në vëmendjen e Komitetit të Auditimit, të raportohen tek autoritetet kompetente;
- f). shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga Kryetari i Komunës dhe
- g). shqyrton raportet e rregullta mbi statusin e zbatimit të planeve të veprimit të miratuara nga udhëheqësi që rezultojnë nga auditimet e mëparshme të brendshme dhe rekomandimet e auditimit të jashtëm.

#### Neni 50

Komunikimi efektiv në mes të Komitetit të Auditimit dhe Njesisë së Auditimit të Brendshëm, është me rëndësi vendimtare për këtë marrëdhënie.

Disa aktivitete kyçe të komunikimit janë:

- a). takimet në mes të komitetit dhe drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm;
- b). raportet përmbledhëse periodike të aktiviteteve të auditimit të brendshëm; dhe
- c). raporti vjetor për aktivitetet e auditimit.

### KAPITULLI XVIII

#### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 51

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të statutit me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dispozitat e ligjit mbizotërojnë.

#### Neni 52

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohet statuti i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Komunën e Gjilanit i datës 31.01.2012.

#### Neni 53


Ky statut hynë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Kryesuesi i Komitetit të Auditimit dhe Kryetari i Komunës.

Drejtor i NJAB-së:

  
/Sherafedin Latifi/

Kryesuesi i Komitetit të Auditimit

Naim Behluli



Datë:

28.10.2019

Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri





